

2 Demografia dhe shëndeti
Kriza e përkujdesjes
shëndetësore dhe pasojat
për shoqërinë

3 Migrantët aktiv
Portretet e aktivisteve
dhe aktivistëve të
angazhuar

4 Këshilla juridike
«Horizonte» përgjigjet
pyetjeve të anëtarëve

Nr. 2 | Mars 2024 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Një Po e qartë për AHV/AVS x 13

Suksesi historik i sindikatave



Gëzimi te nismëtarët ishte i madh pas kumtimit të rezultateve të votimit.

Më 3 mars 2024, votuesit zviceranë miratuan me mbi 58 përqind nismën popullore «Për një jetë më të mirë në pleqëri» (iniciativa për pensionin e 13-të AHV-AVS). Është padyshim një sukses historik për sindikatave. Dhe një fitore e madhe e solidaritetit dhe drejtësisë sociale. Shumica e votuesve dhe e kantoneve e pranuan iniciativën e pensionit të 13-të të AHV-së me një shumicë çuditërisht të madhe. Në të njëjtën kohë, iniciativa e radikalëve të rinj për rritjen e moshës së pensionit u refuzua qartë. Për pensionistët do të thotë kjo kompensim për shtrenjtimin. Një hap drejt më shumë solidariteti për të gjithë popullatën. Nuk është vetëm simbolikisht shumë i rëndësishëm. Na jep shpresë për një ndryshim në perceptimin e shoqërisë.

Marek Wieruszewski

Me 58.2% vota pro, rezultati ishte më i qartë se sa ishte parashikuar nga sondazhi i fundit. Kundërshtarët e nismës janë munduar me shumë para të investuare në fushatë, të frikësojnë popullin që të mos thotë po. Por mobilizimi i madh i sindikatave dhe një kontribut vendimtar në suksesin e madh. Ne arritëm të mobilizojmë njerëzit që normalisht nuk shkojnë në votime. Nuk ishin vetëm sindikatave që bënë një punë të shkëlqyer. Për pensionin 13 luftuan edhe shumë aktiviste dhe aktivist sindikal krahas me njerëzit e përkushtuar nëpër shoqatat e migracionit.

Përpjekja e madhe ia vlejti

Sipas politologut Lukas Golder, në këto votime kishte dy ndjesi apo bujë:

E para ishte një Po për pensionin e 13-të. E dyta është pjesëmarrja e lartë e lartë e njerëzve në votime. Ishte pjesëmarrja e nëntë më e lartë e votuesve që nga futja e të drejtës së votës së grave. Kur shohim rezultatin e votimit, del qartë se pjesa më e madhe e njerëzve që kanë të ardhura të larta kanë qenë kundër pensionit të 13-të, por ata me të ardhura të ulëta këtë herë i kanë tejkaluar dukshëm.

Përmirësim konkret për shumë pensionistë në nevojë

Nisma përmirëson ndjeshëm situatën e shumë pensionistëve. Tani duhet të zbatohet nga Parlamenti. Pensioni i 13-të i AHV-AVS së pritet të paguhet nga 1 janari 2026 dhe do të sjellë një rritje prej 8.33 për qind. Pra, pensioni

më i ulët individual i pleqërisë nga AHV-AVS do të rritet me 1225 franga. Çiftet e martuara marrin deri në 3675 franga shtesë në vit në formën e një pensioni prej 13.

Ndryshimi simbolik në perceptimin e shoqërisë

Përveç përmirësimeve konkrete, suksesi i iniciativës jep shpresë se perceptimi i shoqërisë në Zvicër po ndryshon dalëngadalë. Është iniciativa e parë e solidaritetit social që pranohet në historinë e Zvicrës. «Rezultati është përparim i madh social për Zvicrën. Ajo krijon besim në të ardhmen e pensioneve të pleqërisë. Dhe kjo ndihmon luftën tonë për paga më të mira, për premi të përballeshme të sigurimit shëndetësor dhe kundër vjedhjes së

pensioneve në shtyllën e dytë», thotë kryetarja e Unia, Vania Alleva.

Një sukses i rëndësishëm për sindikatave

I rëndësishëm ishte edhe refuzimi i qartë i nismës së pensioneve të Liberalëve të Rinj. Vetëm 25.3% u shprehën pro rritjes së moshës së pensionit. Nga këndvështrimi i sindikatës, refuzimi i qartë është një sukses i madh. Argumentet tona arritën dhe bindën njerëzit, të cilët politikisht janë pjesë e borgjezisë. Ky rezultat është gjithashtu një shenjë e qartë kundër shkurtimeve të mëtejshme sociale në sigurimin e pensioneve dhe përkeqësimit të pensioneve.

Editorial



Të dielën në mëngjes, në ditën e votimit për pension të 13 të pleqërisë, më erdhi një mesazh i një kolegu, i cili gjithashtu është natyralizuar si unë: «A do të fitojmë?». Në përgjigjen time doja të tregoja optimizëm, por edhe t'i jepja kurajë vetvetes dhe u përgjigja: «Nuk e di, por rezultati do të jetë pozitiv». Me pastaj më dërgon një foto, ku shihet ai duke hedhur në kutinë e postës zarfin e votimit.

Kjo fotografi dhe pyetja «A do të fitojmë», flasin shumë për rëndësinë që ka pas ky votim për njerëzit në Zvicër dhe tregon për angazhimin e madh të kolegeve dhe kolegëve me sfond të migracionit, që ky rezultat të arrihet. Aktivistet dhe aktivistët e Unia kanë shpërndarë material dhe kanë biseduar me njerëzit në vend të punës, në xhami dhe kisha, nëpër festa familjare dhe të shoqatave të tyre. Në mediat sociale dhe WhatsApp janë shpërndarë vazhdimisht foto dhe video nga aktivitetet. Kjo më bënte optimist, se do të fitojmë.

Mesazhi i dytë prej kolegut erdhi mu atë ditë në ora 13:01 «Urime rezultati. Faleminderit për punë tande».

Në këtë moment shumë prej nesh kemi kuptuar, se kemi arritur diçka të pabesueshme. Më 3 mars ne së bashku shkruam një pjesë të historisë. Është thjeshtë diçka e mrekullueshme. Faleminderit aktiviste dhe aktivist për punën tuaj të palodhshme. Forca jonë qëndron në veprimin kolektiv dhe solidar. Ne do të vazhdojmë kështu sepse së shpejti do të mund të luftomë shkurtimeve të Pensioneve nga arkat e pensionit BVG/LPP. Me të njëjtin përkushtim, fuqi dhe vullnet do të dalim me sukses edhe në etapën e ardhshme për pensione më të mira dhe rritje të fuqisë blerëse.

Hilmi Gashi

News

Fitore për personelin e shitjes në Kantonin e Valisit (VS)

Votuesit e Valisit i thonë jo ligjit kantonal për orët e hapjes së dyqaneve (LÖG), i cili parashikonte orar më të gjatë të hapjes dhe zgjerimin e zonave turistike. Në këtë mënyrë, elektorati solidarizohet me stafin e shitjeve. Sepse shitësit tashmë po luftojnë me pagat e ulëta dhe kushtet e vështira të punës. Së bashku me Unia, personeli i shitjeve ka arritur tashmë suksese të shumta në vitet e fundit. Çdo zgjatje e orarit të hapjes së dyqaneve rezulton gjithashtu në rritje të orarit të punës për punonjësit. Kjo jo vetëm që dëmton shëndetin e tyre, por ndikon edhe në jetën e tyre shoqërore dhe familjare.

Mbyllja e Micarna: Thyesit e grevës në vend të negociatave



Punonjësit e fabrikës së mishit, Micarna, një filiale e Migros me qendër në Ecublens (VD), vazhdojnë grevën. Fabrika e tyre me 84 vende pune pritet të mbyllet. Grupi Migros refuzon të fillojë bisedimet në lidhje me mbylljen e paralajmëruar të fabrikës. Në vend të kësaj, «Migros Group» po i vë nën presion dhe ka bërë përpjekje të mëdha për të organizuar thyesit e grevës të organizuar nga dy kompani për punëtorë të përkohshëm (temporer). Kjo është e ndaluar shprehimisht nga kontrata kolektive e punës për firmat tempore.

90 përqind e punonjësve i kanë dhanë mandatin Sindikatën Unia për t'i përfaqësuar ata. Duke vazhduar grevën e tyre, punëtorët përsërisin kërkesën e tyre që menaxhimenti i Micarna dhe Migros të fillojnë dialogun për të filluar sa më shpejt negociatat.

Unia 2023 me zhvillim pothuajse të qëndrueshëm të anëtarëve

Rritja e numrit të anëtarëve në profesionet e shërbimit, më shumë anëtare femra dhe shumë anëtarë që punojnë – zhvillimi i anëtarësimit në Unia në 2023 është mbresëlënës. Rënia e numrit të pensionistëve dhe atyre të papunësuar e zbeh rezultatin pozitiv.

Pikërisht, sindikata Unia kishte 174 450 anëtarë në fund të vitit 2023. Kjo do të thotë se numri i anëtarëve ka mbetur pothuajse i qëndrueshëm krahasuar me një vit më parë. Vitin e kaluar, sindikata mundi të rritë numrin e anëtarëve në sektorin e shërbimeve: në mbi 53 000, numri i anëtarëve në këtë sektor është më i madh se në sektorët «tradicionale» të ndërtimit, artizanaleve dhe industrisë. Kjo shoqërohet me një rritje të vazhdueshme të përqindjes së grave. Unia ka zbutur humbjet në zhvillimin e anëtarësimit, gjë që ishte më e dukshme në vitet e Koronës. Tani, Unia synon të kthehet në rrugën e rritjes së numrit të anëtarëve.

Punonjësit e kulturës: Të ardhura të pamjaftueshme dhe sigurime shoqërore të pasigurta

Punonjësit e kulturës shpesh kanë të ardhura shumë të ulëta dhe boshllëqe të mëdha në sigurimet shoqërore. Bashkimi Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS), së bashku me shoqatat e saj kulturore, është e përkushtuar të sigurojë që pagat e duhura të promovohen brenda kornizës së politikës kulturore kombëtare dhe të zgjerohet siguri social për punonjësit e kulturës – veçanërisht në pension të pleqërisë AHV/AVS dhe në sigurimin e papunësisë. Megjithatë, këshillat dhe ofertat e reja të shërbimeve do të jenë efektive vetëm nëse shoqatat kulturore tani e tutje përfshihen nga afër në punën e zbatimit. Këshilli Federal tani ka vendosur ta trajtojë «kulturën si një botë pune» si fokusin e politikës kulturore kombëtare gjatë katër viteve të ardhshme, gjë që Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës e mirëpret.

Kriza e kujdesit në infermieri:

Të ndërtohen aleanca sindikaliste dhe të shoqërisë civile për një kthesë

Nevoja për kujdes dhe mbështetje po rritet. Në të njëjtën kohë, disa qindra infermierë largohen nga profesioni i tyre çdo muaj. Fajin për këtë e kanë një sërë vendimesh politike që synojnë frenimin e kostove që rrjedhin nga zhvillimet demografike. Nevojitet një mobilizim solidar.



Shëndeti mbi profitin: sfidat për shoqërinë tonë.

Marie Saulnier Bloch

Një krizë kujdesi me ndikime për shoqërinë në tërësi

Sipas Entit Federal të Statistikave, deri në vitin 2040 numri i personave mbi 65 vjeç do të rritet me 52% dhe numri i personave mbi 80 pothuajse do të dyfishohet (+88%). Kjo qon në një rritje prej 56% të nevojës për përkujdesje afatgjatë të të moshuarve. Dhe një politikë e pandryshuar e kujdesit do të kërkonte rreth 60% më shumë shtëpi pleqsh. Ky boshllëk është vështirë për t'u mbushur me migrantë. Nga njëra anë, për shkak të regjimit kufizues të emigracionit të Zvicrës, dhe nga ana tjetër, për shkak të rritjes së nevojës për përkujdesje tjetërkah. Në Europë, qysh tani po përpiqen që vendet

përreth të mbajnë kujdestarët «e tyre» me masa të synuara. Nëse nuk është i mundur kujdesi përmes mbështetjes profesionale, do të duhet që të afërmit të plotësojnë boshllëkun. Kjo ashpëron mungesën e fuqisë punëtore dhe çon në humbje ekonomike, më shumë pabarazi sociale dhe më shumë pabarazi gjinore për të prekurit.

Duhet të krijohen kushte pune për të mbajtur personelin në këtë sektor dhe për të reduktuar kërkesën për shërbime të kujdesit. Për të mundësuar këtë, duhet të krijohen dhe financohen oferta shtesë si jetesa e asistuar, kujdesi ambulator dhe mbështetja e përditshme. Kjo çon në një rritje kostojë dhe në një ndryshim të financimit. Nuk mund të jetë detyrë e të siguruarve që ata ta paguajnë këtë nga xhepi i tyre. Përqindja e rimbursimit publik për shërbimet e kujdesit duhet të zgjerohet shpejt dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Përgjegjësia e sindikatave dhe shoqatave

Për Enrico Borelli dhe Samuel Burri, përgjegjës të sektorit të kujdesit afatgjatë në Unia, është urgjentisht e nevojshme të ankorohen sindikatat më fort në ndërmarrje dhe të aftësohen kujdestarët që të organizohen për të përfaqësuar interesat e tyre në rrugë dhe në vendet e tyre të punës. Ne kemi nevojë për një lëvizje të fortë që mbështetet paralelisht nga forcat progresive të shoqërisë civile. Vetëm së bashku mund të ndikojmë në debatin politik. Këtë ia kemi borxh shoqërisë sonë, si të moshuarve ashtu edhe brezave të ardhshëm.

Punonjësit realizojnë 575 milionë fitim

Sukses për Coop – tani është radha të punëtorët!

Grupi i ndërmarrjes tregtare «Coop» ekonomikisht po ecën shumë mirë. Punonjësit e Coop realizuan 575 milionë fitim në vitin e kaluar. Kjo d.m.th. një rritje prej 2.13 për qind. Shitjet gjithashtu u rritën me 2.2 për qind. Punonjësit kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në suksesin e Coop prej viteve. Kjo është edhe më e rëndësishme të njihet, edhe për faktin se ata janë të ekspozuar ndaj presionit dhe stresit më të madh.

Darinka Filipovic

Falë angazhimit të tyre të fortë sindikal, ata, në bisedimet e fundit për paga, arritën një rritje të rëndësishme pagash. Por, për anëtarët e Unia është e qartë: një hap përpara në një degë ekonomike e karakterizuar me paga të ulëta, nuk është fundi i linjës. Ekziston një nevojë urgjente për veprim dhe shumë hapësirë për përmirësim si në paga ashtu edhe në kushtet e punës. Viti financiar i suksesshëm tregon edhe një herë se Coop mund të përballojë të investojë në personel dhe kushte pune.

«Coop Group» është pozicionuar mirë falë punonjësve të saj

Rritja e fitimeve dhe e shitjeve (+2.13% dhe +2.2%), rritja në supermarkete dhe në coop.ch (+2.4%) si dhe zhvillimi pozitiv në dyqanet Coop City dhe në sektorin e ushqimit me porosi (Katering) tregojnë se Coop po shkon mirë ekonomikisht. Me rritje shtesë në kapital, Coop qëndron



Anëtarët e Unia në Coop po bëhen gati për negociatat mbi marrëveshjen e re kolektive të punës.

mbi – siç thonë ata – «themele të forta financiare».

Sektori i shitjes me pakicë me paga të ulëta: Coop ka vend për përmirësim

Punonjësit në sektorin e shitjes me pakicë po vuajnë

- një shtim i detyrave në punë
- aftësia e pamjaftueshme e planifikimit
- dhe stresin shoqërore, veçanërisht për punonjësit me kohë të pjesshme.

Ditët e gjata të punës dhe puna në fundjavë janë në rend të ditës për shumë punonjës.

Unia dhe anëtarët e saj janë të përkushtuar të sigurojnë, që marrëveshja e re kolektive e punës, e cila do të negociohet në vitin 2025, të marrë parasysh këto sfida në Coop. Bilanci vjetor i komunikuar sot e bën të qartë: Coop ka hapësirë për përmirësim dhe ndryshime për të përmirësuar kushtet e punës – punonjësit më shumë se sa e meritojnë.

Së bashku për kushte të mira pune!

Bëhuni anëtar i Unia

Intervista me katër aktiviste e aktivistë të Unia

Delegatët e grupeve të migracionit nga regjionet, në mbledhjen e Komisionit të Migracionit të Unia më 24 shkurt, përcaktuan synimet për vitin 2024 dhe diskutuan mbi aktivitetet e planifikuara. Ne pyetëm katër delegatë se çfarë do të thotë për ta sindikata Unia dhe grupi i migracionit të Unia dhe pse janë angazhuar në Komisionin e Migracionit.

Nga Emine Sariaslan



Lazim Bakija, deri në daljen në pension ka punuar si skelendër-tues. Sindikata për te është shumë e rëndësishme: «U anëtarësova në Unia sepse ajo mbron të drejtat e të gjithë punëtorëve dhe angazhohet për preokupimet e tyre. Për Unia-n nuk ka rëndësi se nga vijnë njerëzit, cilit besim fetar i përkasin, çfarë statusi qëndrimi posedojnë apo çfarë ngjyre lëkure kanë. Unia mbështet edhe kurset e gjuhës dhe trajnimet. Tek Unia kam gjetur mbështetje për të marrë shtetësinë». Për ta bërë më të fortë Unia-n, nevojiten anëtarë. Kështu Lazimi rekruton edhe anëtarë të rinj dhe shpërndan gazetën dhe informacionet e Unia në rrethin e tij dhe gjithmonë edhe nëpërmjet punishtet e ndërtimit. Lazimi angazhohet edhe për të drejtat e personave pa leje qëndrimi (Sans-Papiers). Për të, grupi i migracionit është një vend ku ai mund të shprehë hapur dhe të flasë për vështirësitë e tij. Ai thotë: «Grupi i migracionit Unia është i rëndësishëm për mua në mënyrë që ne si migrantë të flasim për problemet tona dhe të luftojmë së bashku. Ne mund t'i adresojmë preokupimet tona deri te drejtoria qendrore dhe menaxhmenti - nga poshtë lart. Unia angazhohet politikisht për preokupimet e shqetësimet tona qoftë për ligjin e të huajve, natyralizimin, Sans-Papiers etj. dhe lanson nisma si pensionin e 13 të AHV/AVS».



Döndü Yildirim, punon qe 25 vite në sektorin ushqimor dhe qe 24 vite është anëtare e Unia si dhe anëtare e kryesisë së regjionit Aargau-Zvicër veriperëndimore. Për të, Unia është «organizata e themeluar nga punonjësit për të mbrojtur dhe përmirësuar të drejtat dhe interesat ekonomike, sociale dhe kulturore të punonjësve». Kjo është arsyeja pse ajo ka vendosur të marrë pjesë aktive në sindikatë. Ajo na tregon për vështirësitë e mëdha që ajo dhe kolegët e saj përjetojnë në punë. «Neve na janë caktuar 4 ndërrime. 4 ndërrime do të thotë të jesh shkëputur si nga jeta familjare ashtu edhe nga jeta shoqërore. Me fjalë të tjera, nuk punon për të jetuar, jeton për të punuar», thotë ajo. Ajo që e zemëron veçanërisht atë është trajtimi i njerëzve që për arsye shëndetësore nuk mund të punojnë me ndërrime: «Punonjësit, shëndeti i të cilëve nuk është i përshtatshëm për ndërrimin e natës, kërkohet të kenë dëftesën përkatëse mjekësore. Punonjësit që nuk mund të dorëzojnë një dëftesë të tillë do të thirren në zyrën e personelit dhe do të ndërpriten marrëdhënia e tyre e punës. Ajo e ka të qartë se së bashku me përgjegjësit e regjionit do të organizojnë një takim me kolegët e punës për t'u mbrojtur së bashku nga ky trajtim. Ajo trajtimin e migrantëve e konsideron të padrejtë». «Me ligjet e reja do të rritet presioni ndaj migrantëve. Janë sindikatat dhe partitë e majta që po luftojnë për dhe bashkë me migrantët kundër legjislacionit kufizues dhe atij të migracionit. Unë jam duke marrë pjesë në Komisionin e Migrantëve për t'u informuar mbi të drejtat e punës së punëtorëve migrantë dhe për të informuar më pas edhe migrantët tjerë».



Olga Pisarek, punon në shërbimin psikiatrik universitar të Bernës, qe dy vite është anëtare e Unia. Menjëherë pas anëtarësimit është aktive në grupin e migracionit dhe ka marrë përsipër edhe detyrën e bashkëkryetares të grupit regional të migracionit MiForte. Për Olgën, sindikata Unia do të thotë mbi të gjitha mbështetje dhe solidaritet në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe migrantëve. «Unia është një organizatë që angazhohet për kushte korrekte pune, paga të barabarta, mbrojtje nga diskriminimi dhe trajnime në vendin e punës. Për mua, UNIA është një vend i rëndësishëm për të ndërtuar një jetë më të mirë dhe më të drejtë pune në Zvicër. Në grupin e migracionit kam mbi të gjitha një ndjenjë komuniteti dhe solidariteti. Së bashku me migrantët e tjerë, të cilët gjithashtu përballen me sfidat e migrimit dhe integritimit profesional, ne formojmë një grup të fortë që punon së bashku për të përmirësuar kushtet e punës dhe të jetesës. Kjo më jep mundësinë të ndikoj në vendimet për çështje që më prekin, edhe nëse nuk kam të drejtë të votoj në zgjedhje. Si rrjedhojë, pavarësisht se nuk mund të marr pjesë në proceset demokratike, megjithatë kam ende mundësinë të ndikoj përkthazi me vendimet që kanë të bëjnë me kushtet e mija të punës dhe të jetesës».



Hayri Akkiz, ka punuar për shumë vite si saldues dhe mekanik në industrinë e metalit në ndërmarrje të ndryshme. Për shkak të një aksidenti në punë është bërë pjesërisht invalid. Ka 14 vite që punon me kohë të pjesshme në një kompani shitje reklamash. Hayri ka 29 vite që është anëtarë i sindikatës. Së pari ai, në vitin 1995, ishte bërë anëtarë i sindikatës së industrisë metalike SMUV dhe pas themelimit të sindikatës Unia, ai iu bashkua asaj. Ai është aktiv në grupin drejtues të grupit të migracionit. Për Hayrin, Unia është shumë e rëndësishme për të mbrojtur fuqinë e tij punëtorë dhe për të luftuar për të drejtat e tij. Ai beson se është thelbësore të forcohet anëtarësimi në sindikata si instrumente fuqizuese për t'ju qasur problemeve të përbashkëta dhe për një jetë më të mirë, në vend që të veprohet individualisht. Ai thotë: «Është e rëndësishme të përdoret anëtarësimi për të punuar së bashku për paga dhe kushte më të mira pune, pasi dëshira për përmirësim nuk mund të ndërtohet spontanisht. Punëtorët duhet të jenë pjesëmarrës në pasurinë që krijojnë përmes punës së tyre dhe të mos kenë nevojë të jetojnë me paga të pa mjaftueshme. Krahas rëndësisë dhe domosdoshmërisë për të qenë i organizuar në sindikatë, punëtorët e huaj, në një vend të huaj, kanë edhe vështirësi dhe probleme shtesë, me të cilat përballen. Diskriminimi, ksenofobia, racizmi dhe puna e vështirë dhe e paguar dobët paraqesin sfida të përhershme. Komisioni i Migracionit është i rëndësishëm për të vepruar në solidaritet me perspektivën e migrantëve në luftën e përbashkët të të gjithë punonjësve kundër këtyre sulmeve ndaj të drejtave themelore».

Intervistë



Intervistë me Hilmi Gashin, drejtues i grupeve të interesit në Unia

Horizonte: Hilmi Gashi, ti në nëntorin e vitit të kaluar ke marrë pjesë në konferencën mbi temën e mungesës së fuqisë punëtoresh profesionale dhe migracionit në ETH të Cyrihut. Në punëtorinë, në të cilën ti ke marrë pjesë, është biseduar për rininë dhe migrantët. Sipas mendimit tënd, cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat përballen migrantët në tregun zvicëran të punës?

Hilmi Gashi: Një nga sfidat më të mëdha është padyshim diskriminimi strukturor me të cilin përballen shumë migrantë. Filluar nga barrierat tek qasja deri tek pengesat në punë dhe në karrierë. Për fat të keq, ekziston një mënyrë qasjeje nga shumë punëdhënës të cilët nuk marrin parasysh aftësitë dhe përvojën e aplikantëve, por përkundrazi përqendrohen në atë që mund të mos jenë ende në gjendje të bëjnë. Rosita Fibbi nga Universiteti i Neuchâtel-it i ra pikës kur foli për një «hierarki të origjinës». Varësisht nga vendi i origjinës është shpesh e vështirë të gesh një punë të kualifikuar.

Horizonte: Cilat masa konkrete u diskutuan në konferencë për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar integritimin e migrantëve?

Hilmi Gashi: Ne biseduam masa të ndryshme për të promovuar pjesëmarrjen e barabartë të migrantëve dhe për të kapërcyer diskriminimin në tregun e punës. Kjo përfshin, për shembull, reduktimin e pengesave strukturore, si atyre ligjore ashtu edhe atyre të natyrës shoqërore. Është e rëndësishme që kualifikimet, aftësitë dhe përvoja që sjellin migrantët me vete të njihen dhe të promovohen. Ka nevojë për njohje joburokratike të diplomave të huaja. Pastaj marrja parasysh e këtyre kualifikimeve në kontratat kolektive të punës. Ato do të ishin të rëndësishme për pagat dhe do të paraqiste një pengesë më pak për karrierën në të ardhmen.

Horizonte: Ti e ke tematizuar gjithashtu edhe situatën e të rinjve. Pse sipas mendimit tënd është e rëndësishme që të rinjtë të mbështeten më mirë në zgjedhjen e profesionit edhe gjatë aftësimin profesional të tyre?

Hilmi Gashi: Të rinjtë luajnë një rol vendimtar në përballimin e mungesës së fuqisë profesionale të punës, por shumë prej tyre për shkak të kushteve të këqija të punës dhe pagave zgjedhin të mos ndjekin një profesion apo mësim zejeje të caktuar. Është urgjentisht e nevojshme që të rinjtë të çmohen e të vlerësohen më shumë, p.sh. përmes pagave më tërheqëse. Nxënia e zejes duhet kuptuar gjithashtu si mësim dhe jo vetëm si punë e pastër produktive. Të rinjtë duhet që gjatë trajnimit të tyre të mbështeten në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë. Mirëpo ata gjithashtu duhet të mbrohen nga shfrytëzimi, mobingu dhe ngacmimi seksual. Mbrojtja e shëndetit dhe siguria në punë gjithashtu luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë moshë.

Horizonte: Ti ke sugjeruar masa konkrete për integritimin e migrantëve dhe përmirësimin e situatës së të rinjve. Çfarë roli luan Unia në lidhje me këto aspekte?

Hilmi Gashi: Unia luan një rol vendimtar në përfaqësimin e të drejtave dhe interesave të punëmarrësve, pavarësisht nga origjina e tyre. Ne jemi të angazhuar në mënyrë aktive për të luftuar racizmin, ngacmimin seksual dhe mobingun në vendin e punës. Përveç kësaj, ne po luftojmë për të siguruar që migrantëve t'u jepen mundësi më të mira integritimi dhe që potenciali i tyre të njihet dhe promovohet në një fazë të hershme. Nëpërmjet punës sonë, ne përpiqemi për një botë pune gjithëpërfshirëse dhe të drejtë, në të cilën të gjithë kanë të njëjtat mundësi, pavarësisht nga prejardhja e tyre.

Imran Sariaslan

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Pyetje të palejuara në intervistën tuaj të punësimit

Motra ime javën e kaluar kishte një intervistë për punësim si bibliotekare. Më ketë rast ajo ishte pyetur nëse do të kishte dëshirë të kishte fëmijë. A lejohet që eprori të shtrojë pyetje të tilla?



Intervista e punësimit: Ju nuk duhet t'i përgjigjeni çdo pyetjeje. (Foto: Adobe Stock)

Gilles Sciboz: Jo. Firma duhet që me pyetje të përshtatshme nga personi aplikues të kuptojë se a përshtatet ai/ajo për vendin e përshkruar të punës. Kjo domethënë, se lejohen vetëm pyetjet që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me vendin e përshkruar të punës. Pyetjet që shkojnë përtej këtij qëllimi shkelin ligjin e detyrimeve, sipas të cilit punëdhënësi mund të përpunojë të dhëna për punëmarrësin vetëm në masën që kjo ndikon në përshtatshmërinë e tij/saj për marrëdhënien e punës. Pyetjet në lidhje me shëndetin e aplikantit ose një shtatzëni të mundshme lejohen vetëm nëse detyrat që duhet të kryhen janë të papajtuashme me problemet shëndetësore ose një shtatzëni ekzistuese. Për shembull, është e mundur që një aplikante të pyetet nëse ajo ka probleme me shpinën kur duhet të mbajë pesha të rënda. Ose për të pyetur për ecurinë e një shtatzënie nëse është fjala për punë natën, punë të rrezikshme ose të lodhshme.

Pyetjet në lidhje me pagën e mëparshme, statusin martesor, historinë kriminale (përveç dënimeve penale që lidhen me krimet e pasurisë për një person që synon të punojë në lëmin e financave ose krime droge kur punon në një spital me opiate), problemet shëndetësore, orientimi seksual ose besimi fetar janë të ndaluara. Dëshira e motrës suaj për të pasur fëmijë nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me detyrat e bibliotekares. Si rrjedhojë, pyetja është e papranueshme. Në këtë rast, motra juaj mund të përdorë të ashtuquajturën «të drejtën e nevojës për të gënjyer» dhe t'i përgjigjet pyetjes negativisht.

(Work, 5.2.24)

AHV-AVS: Kur do të pensionohem?

Unë s'vijet i mbushi 64 vjet (viti i lindjes 1960). Vitin e kaluar përgjegjësi i personelit (HR) më tha se në vitin 2024 do të pensionohesha. Kur unë në dhomën e pushimit njoftova me kënaqësi se po pensionohesha këtë vit, kolegët e mi më thanë se nuk mund të ishte e vërtetë. Një kolege që nuk ishte shumë më e re më tha se HR i kishte thënë asaj se nuk mund të pensionohet deri në moshën 65-vjeçare. A do të mund të pensionohem në vitin 2024?

Marina Wyss: Po, ju i takoni grave të vitit të fundit të lindjes, që me mbushjen e moshës 64 vjeç arrijnë moshën e pensionimit. Më 25 shtator 2022 në kutinë e votimit u miratua reforma AHV/AVS 21. Unia e luftoi këtë propozim sepse ai rriti moshën e daljes në pension për gratë. Reforma ka hyrë në fuqi me 1 janar 2024. Nuk flasim më për moshën e rregullt të pensionimit. Porse për moshën referuese, e cila si për femra dhe meshkuj është e përcaktuar njëjtë me 65 vjeç. Për brezin në tranzicion, moshë referuese e grave do të rritet gradualisht me tre muaj në vit. Më shumë informacion dhe këshilla të përpikta për situatën tuaj ju mund të merrni nga arka e kompensimit.

(Work, 16.2.24, e përshtatur)

AHV-AVS: A mund të marr pension të pjesshëm tani?

Unë kam lindur në vitin 1962 dhe me 64 vjeç e 6 muaj po mbush moshën referuese për pension. Me reformën AHV/AVS 21 unë i përkas brezit të tranzicionit. Vajza ime që është në marrëdhënie pune ma bëri me dije se është në pritje të një fëmije në Krishtlindje. Ajo planifikon që pas pushimit të lehonisë të kthehet në punë me kohë të plotë. Do të doja të kujdesesha për fëmijën e saj kur vajza ime të fillojë sërisht punën. Isha në arkën e kompensimit dhe pyeta nëse duhet të pensionohesha para kohe. Arka e kompensimit më shpjegoi se mund të aplikoj për një pensionim të pjesshëm të parakohshëm. Në varësi të kohës, do të zbatohet edhe një normë më e ulët shkurtimi. A mund të marr para kohe një pension të pjesshëm dhe të vazhdoj të punoj me kohë të pjesshme?

Marina Wyss: Po, kjo është një mundësi e re që gjen zbatim me hyrjen në fuqi të legjislacionit të ri të AHV/AVS. Tani në fakt mund të merrni një pension të pjesshëm. Arka e kompensimit për ju mund të llogarisë opsione të ndryshme. Mund shumë informacion mund të gjeni në këto video shpjeguese: rebrand.ly/videos-ahv.

(Work, 5.2.24)

Unia nisi Manifestin mbi uljen e orarit të punës

Më shumë kohë për të jetuar

Unia kërkon orar më të shkurtër pune me të njëjtën pagë. Nënshkruaj manifestin për uljen e orëve të punës dhe mbështet angazhimin për kohë më të lirë të disponueshme krahas punës fitimprurëse.

Mirjam Brunner, sekretare specialiste e bazave politike

Me një mesatare prej 41.7 orë pune në javë, punonjësit me kohë të plotë në Zvicër punojnë më së gjati në të gjithë Europën (shih grafikun). Shumë nga ta punojnë edhe më shumë sepse ligji lejon javë pune deri në 50 orë. Kjo është e tepërt. Këta orar të gjatë pune dëmtojnë shëndetin. Gjithashtu, ritmi dhe intensiteti i kërkuar i punës vazhdon të rritet gjithnjë e më shumë. 28% e punonjësve në Zvicër ndihen të stresuar në punë. Rreziku, që ata të përjetojnë dërrmimin rritet, veçanërisht tek njerëzit me të ardhura të ulëta. Kjo është e padrejtë. Neve na takon më shumë kohë për tu çlodhur nga ngarkesat në punë!

Ulje e përgjithshme e orarit të punës për më shumë barazi

Punët e nevojshme familjare dhe shtëpiake nuk mund të kryhen krahas ngarkesave kaq të larta të punës me kohë të plotë. Prandaj, puna me kohë të pjesshme si zgjidhje individuale është veçanërisht e përhapur tek gratë. Ato marrin paga më të vogla, pensione më të ulëta dhe disfavore përkitazi trajnimeve të mëtejshme dhe mundësive për karrierë. Ne kemi nevojë për një ulje të normës së punës me kohë të plotë, në mënyrë që të gjithë të kenë më shumë kohë për punë pa pagesë.



Nëse ulja e orarit të punës jep fryte (workzeitung.ch)

Skano kodin QR tani dhe nëshkruaj manifestin për më shumë kohë për të jetuar!



Manifesti për uljen e orarit të punës – nëshkruaj tani – sindikata Unia



Manifeste-QR-Code-de.docx (unia.ch)

Më shumë kohë e lirë me të njëjtën pagë është e mundur

Për një jetë të mirë nevojitet më shumë kohë dhe më shumë para. Andaj ne kërkojmë rritje pagash së bashku me më shumë kohë të lirë. Mes viteve 2016 dhe 2022, produktiviteti i punës në Zvicër është rritur me 10.3%. Ndërsa, pagat nominale u rritën vetëm me 3.4%. Një rishpërndarje e përfitimeve të produktivitetit përmes më shumë kohë të lirë do të ishte një plotësues i rëndësishëm për rritjen e pakët të pagave. Përveç uljes së orarit të punës me kohë të plotë, kërkesat për më shumë mbrëmje të lira, fundjava të rregullta pushimi, heqja e ndërrimeve të ndara, pushimet me pagesë, më shumë pushime dhe ditë feste me pagesë si dhe pensioni i parakohshëm janë gjithashtu pjesë e luftës sonë për më shumë kohë të disponueshme personale.

8 Marsi: Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Grave

Ditë veprimi në mbarë Zvicrën në degët e gastronomisë

Më 8 mars, gratë së bashku me Sindikatën Unia kërkojnë paga më të larta, kushte më të mira pune dhe veprime të vendosura kundër ngacmimeve seksuale në vendin e punës. Unia gjithashtu ka nisur një fushatë për të rritur ndërgjegjësimin për sulmet seksuale në shërbimet hoteliere dhe të restoranteve, pra gastronomisë.

Hilmi Gashi

Gjysma e të gjitha grave që punojnë marrin si pagë më pak se 4126 franga. Ata bëjnë pjesën më të madhe të punës së kujdesit në familje dhe për këtë arsye nuk arrijnë të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme. Situata e shumë e grave migrante është veçanërisht e vështirë: përveç diskriminimit gjinor, ato përballen me racizëm, kenofobinë dhe forma të tjera të diskriminimit të shumëfishtë. Për më tepër, shumë gra janë ende të prekura nga dhuna dhe ngacmimi seksual.

Veprimet dhe kërkesat e protestuesve ndaj gastronomisë

Këtë vit, punëtorët e gastronomisë demonstruan më 8 mars në të gjithë Zvicrën për paga më të larta dhe kushte më të mira të punës. Unia i mbështet këto kërkesa dhe bën thirrje për t'i dhënë fund punës në gatishmëri dhe për të rritur kontrollin e ndërmarrjeve.

Ndal ngacmimeve seksuale!

Së bashku me punonjësit dhe punonjëset e gastronomisë, Unia ka nisur një fushatë kundër ngacmimeve seksuale në vendin e punës. Fletëpalosjet dhe afisjet synojnë t'i shpallin kompanitë si «zonë e lirë nga ngacmimet». Unia kërkon bashkëpunim edhe me shoqatat e punëdhënësve, për të garantuar mbrojtjen e punonjësve.

Më shumë informacione rreth fushatës: <https://bit.ly/4a48ayN>



Gratë kërkojnë barazi dhe ndalimin e ngacmimeve seksuale në vendin e punës dhe në jetën e përditshme

Abono «Horizonte» falas!



Abono «Horizonte»

«Horizonte» u themelua për të informuar koleget e kolegët tanë me sfond migracioni në gjuhën e tyre të kuptueshme rreth zhvillimeve rreth migracionit dhe politikën e sindikatave. Anëtarë dhe lexuesit e gjerë mund të informohen në gjuhën shqipe mbi Kontratën kolektive të punës, pagat, nismat politike. Gjithashtu botojmë intervista, portrete, agjenda për ngjarjet dhe u përgjigjemi pyetjeve të anëtarëve tanë.

Për t'u siguruar që jeni gjithmonë të informuar kur del numri më i ri i «Horizontit», na duhet adresa juaj aktuale e i-melit ose numri juaj i telefonit celular. Ju lutemi plotësoni formularin e duhur për t'u abonuar në «Horizonte» pa pagesë. Të dhënat tuaja do të mbahen të fshehta.